



Prishtinë / Pristina  
Nr./Br. 150-2018

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, neni 3.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 31.01.2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. ZENEL JAKUPI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Zubin Potok, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z. Agim Hasani**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z. Agim Hasani**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 15.01.2018, nr.73/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z. Agim Hasani, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të emërimit në pozitën e nënkryetarit të komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z. Zenel Jakupi, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 31.01.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Priština  
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA  
Valdete Daka